



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Prodato Received / Delivery	23.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHQK	8427/2022		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.951/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.951/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë _____ në Komune të Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.951/2022 e datës 26.10.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 08/2022 i datës 04.10.2022 i Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, si dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga ky vendim.
- III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës II të dispozitivit, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesit, _____ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Komisioni disiplinor me datë 04.10.2022 përmes Vendimin me numër: 08/2022, i ka shqiptuar masën disiplinore ankuesit "ndalim prej 30 % të pagës për periudhën prej katër (4) muaj",

me arsyetimin se i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi i pa knaqur me Vendimin me numër protokolli 08/2022 të datës 04.10.2022 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, me datës 26.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me numër Anr.951/2022 e protokolluar me numër 6463/2022, me pretendimet ankimore që të anulohet se vendimi i komisionit disiplinor, në përputhje me faktet dhe dëshmitë e tij, duke kërkuar të drejtën materiale dhe që ankuesit ti bëhet kompensimi për ndalimin e 30% të pagës për periudhën prej kater (4)muaj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.11.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ndërsa Këshilli, më datë 25.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datë 08.12.2022 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me nr.186/2022 për vazhdimine afatit të ankesës me numër Anr.951/2022 të datë 26.10.2022, lidhur me kërkesën e datës 08.12.2022 të Kryetarës së Kolegjit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të natyrës së lëndës specifike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6463/2022 të datës 26.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokolli 08/2022 i datës 04.10.2022 i Komisionit Disiplinor; Vendimi me numër protokolli 07/2022 i datës 02.09.2022 për vazhdim të afatit të Komisionit Disiplinor; Vendimi me numër protokolli 1025/2021 i datës 27.09.2021 për themelimin e komisionit disiplinor; Vendimi me numër protokolli 861/2021 i datës 27.09.2021 për themelimin e komisionit disiplinor; Njoftimi për sigurimin e provave të datës 22.09.2022, nga Ankuesi-Udhëheqës i DTISHL, për z. . Udhëheqësin e Divizionit të Personelit; Kërkesë e datës 29.09.2022 për Deponim të Materialit për komisionin disiplinor si prova të Takimit të komisionit të datës 27.09.2022 në MKRS/203, bashkangjitur shkresë në lidhje me pikën 2 të pretendimeve: E-maila - prej 1/5 faqe; Kërkesë me numer 3411/2022, e datë 04.10.2022 për inicim të procedurë disiplinore; Vendimi Nr.153/2022 i datës 17.10.2022 për shfuqizimin e vendimit Nr.132/2021 të datës 04.11.2021 me numër protokolli 4198/2021, për caktimin e zv.të Sekretarit të Përgjithshëm MKRS-së; Vendimi Nr.26/2022 të datës 28.01.2022 për themelimin e komisionit disiplinor; Kërkesë i datës 16.08.2022 për lyerje të zyreve dhe korridoreve të MKRS-së, E-mail i datë 15.02.2022, 16.02.2022; Vendimi Nr.05/2022 i datë 31.01.2022 bazuar në vendimin nr.11/56 të datës 26.01.2022 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i nxjerrë nga Ministri i MKRS-së për kompensimin e Komisionit Shtetror; Vendimi Nr.11/56 i datë 26.01.2022 Ndryshohet dhe plotësohet pika 2 e Vendimit të Qeverisë Nr.26/19 të datës 14.07.2021, ndryshim dhe plotësimin e nenpikës 2.3, 2.6 dhe shtohet nënpika 2.15, 2.16 si dhe pika 4, 5 dhe 6 të k'tij vendimi i lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës; Vendimi Nr.07/2022 i datë 31.01.2022 Plotësim Ndryshim i Vendimit me nr.112/2021 i datës 20.09.2021 dhe me nr.3325/2021 i datës 21.09.2021 i nxjerrë nga Ministria e MKRS-së; Email i datës 01.04.2022, i datës 24.03.2022, i datës 25.03.2022 i datës 21.03.2022, i datë

18.03.2022 prej 1/3 faqe; Email i datës 10.03.2022; Dokument nga znj.N.V.Ë, janar 2022, shkurt 2022; E-mail i datës 15.03.2022, i datës kalkulimi i angazhimeve, lidhur me emailin e datës 17.03.2022, i datës 15.03.2022; E-mail i datës 22.03.2022 nga z. për ankuesi; Kërkesë e datës 28.02.2022 për kompensimin të angazhimit në periudhën korrik 2021 –shkurt 2022 të anëtarëve dhe Sekretarit të Komisionit Shtetror për dokumentimin dhe vlerësimin e trashigimisë kulturore të dëmtuar nga forca serbe gjatë luftës 1998/99; Tabela 1. Angzhimi gjatë muajit shtator 2021; Tabela 3. Angzhimi gjatë muajit dhjetor 2021; Tabela 5. Angzhimi gjatë muajit shkurt 2022, me Tab.6.përmbledhjen etë të gjitha takimeve, Aktivitetet dhe produktet korrik 2021, shkurt 2022; Vendimi Nr.112/2021 i datës 20.09.2021 emertimi i Sekretariatit në kuadër të Komisionit Shtetërorë për hulumtim; E-maili i datës 28.03.2022-agjenda e takimit janar 2022 nga z. ,për znj. , E-maili i datës 16.06.2022 draft agjenda e takimit të komisionit qeshor 2022, nga znj. . për ankuesin, dhe i datës 13.06.2022 dhe i datës 10.06.2022; E-mail i datës 21.03.2022 për ankuesin nga z. kalkulimi, angazhimit të znj në Komisionin Shtetërorë; email i datës 17.03.2022 për znj. , nga ankuesi; E-mail i datës 31.03.2022 nga z. për ankuesin, i datës 22.03.2022; Vendimi Nr.26/19 i datë 14.07.2021, Emërohet Komisioni Shtetëror për hulumtimin, regjistrimin, inventarizimin, vlerësimin dhe dokumentimin e objekteve të trashigimisë kulturore dhe historike të shkatëruara gjatë luftës së vitit 1998/99; Komisioni shtetror i datës 18.02.2022; E-maili i datës 30.05.2022, E-mail i datës 26.05.2022 nga z. për z. dhe e-mail i datës 15.03.2022; Ndryshim i marrëdhënies së punës në shërbimin civil; Njoftim i datës 04.08.2022 për inicim të procedurës disiplinore nr. 34271/2022; E-mail i datës 08.09.2022, i datës 06.09.2022, i datës 26.08.2022 ftesë për takim; Email i datës 24.08.2022; Email i datës 01.02.2022, i datës 09.02.2022, i datës 2.08.2022 tekst sqarues lidhur me ankesat; E-mail i datës 12.08.2022 prej 1/3 faqe; Email i datës 19.05.2022, i datës 20.05.2022; Email i datës 27.07.2022 kërkesë për shqyrtim të ndërlydhjes me SMIL; Email i datës 05.07.2022 kërkesë nga z për ankuesin prej 1/3 faqe dhe emaili i datës 22.06.2022, nga z. për z. , i datës 17.06.2022; E-mail i datës 20.06.2022 i datës 16.06.2022 i datës 15.06.2022 nga z për strukturën për shpallje në EEB të MKRS-së; Email i datës 12.01.2022 nga z. për ankuesin Raport nga SIMFK, dhe i datës 12.01.2022; E-mail i datës 22.12.2022 dhe i datës 14.12.2022 zbatim i memorandumit MKRS-MASHT-MAPL; Email i datës 17.12.2022 platforma dixhitale MKRS nga z. dhe emaili i datës 05.11.2021 nga z. për ankursin; Email i datës 12.10.2021 nga z.K.K për ankuesin përmbledhja e takimit -ftesë për takim rreth dixhitalizimit të bibliotekave dhe emaili 12.10.2021 nga ankuesi për dhe E-maili i datës 08.10.2021 nga ankuesi për z E-mail i datës 30.09.2021 sistemimi i menaxhimit nga z për ankuesin prej 1/3 faqe; Email i datës 30.03.2021 nga ankuesit për z. Projekti: Nr. Reference ASHI.166/2020 i datës 11.11.2020 - sistemi i menaxhimit të informacionit për regjistrim , i lëshuar nga Kryesuesi i komisionit për vlerësimin e projekteve të fushës së TI-së, Aneks I. plani ideor i projektit, Thirrja për projekt propozimet e kulturës 2022 Art dhe Trashigimi Kulturore i datës 01.04.2022 prej 1/5 faqe, Lista përfundimtare e përfituesve individ të thirrjes publike Nr.4418/2022 i datës 28.09.2022 prej ½ faqe; Lista paraprake e datës 03.08.2022 e OJQ-ve; Lista paraprake e datës 19.08.2022 e OJQ-ve prej 1/5; Thirrja për projekte –propozimet kujturore 2022 prej 1/18 faqe; Rikujtim: Kërkesë për Sigurimin e Transkriptit dhe Audio-incizimet të takimit të komisionit disiplinor e datës 27.09.2022, me numër protokollit 4824/2022; Kërkesë e datës 29.09.2022 me nr. 4457/2022 për Sigurimin; Kërkesë për deponim i datës 30.09.2022 nr. 4491/2022; Përgjigje në kërkesë me nr.protokollit 7413/2022 të datës 25.11.2022; Përgjigje në kërkesë me nr.protokollit 5720/2022 të datës 24.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me nr.protokollit 7216/2022 të datës 18.11.2022; E-mail I dërguar nga për të datës 05.10.2022 me korrespondim prej 1 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 21.09.2022; E-mail I dërguar nga për me korrespondim prej faqe 1-2; E-mail I dërguar nga për të datës 05.08.2022 me

korrespondim prej 1 faqe; Vendim I lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me numër protokolli 2758/2022 të datës 20.06.2022; Përshkrim I detyrave të punës të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit të datës 08.11.2021; Akt emërim I lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit për ankuesin me numër protokolli 2384/2011 të datës 08.11.2011; Përgjigje në kërkesë me numër protokolli 7441/2022 të datës 25.11.2022; Përshkrimi I detyrave të punës të lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me numër protokolli 1029/4/2013 të datës 26.03.2013; E-mail I dërguar nga për të datës 26.08.2022 me korrespondim prej 1 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 21.09.2022 me korrespondim prej 1 faqe; E-mail i dërguar nga për të datës 05.10.2022 me korrespondim prej 1 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 02.08.2022 me korrespondim prej faqe 1-4 ;E-mail I dërguar nga për dhe të datës 19.09.2022 me korrespondim prej 1-4 faqe; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 19.09.2022 me korrespondim prej 1-7 faqe; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 19.09.2022 me korrespondim prej 1-7 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 01.04.2022 me korrespondim prej 1-6 faqe; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 18.02.2022 me korrespondim prej faqe 1-2; Dokumentimi I aktiviteteve të punës Shkurt 2022 të të datës 24.02.2022 me korrespondim prej faqe 1-3; Komisioni shtetëror për hulumtim. Regjistrim, dokumentim, dhe vlerësim të trashëgimis kulturore të Kosovës të shkatërruar nga forcat Serbe gjatë luftës së viteve 1998/1999 të datës 18.02.2022 Cambridge; E-mail I dërguar nga për të datës 21.03.2022 me korrespondim prej 1-2 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 21.03.2022 me korrespondim prej 1-7 faqe; E-mail I dërguar nga për , dhe të datës 16.06.2022 me korrespondim prej 1-4 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 25.03.2022 me korrespondim prej 1-6 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 10.02.2022 me korrespondim prej 1-2 faqe; E-mail i dërguar nga për të datës 01.04.2022 me korrespondim prej 1-5 faqe; E-mail I dërguar nga për , të datës 12.08.2022 me korrespondim prej 1-4 faqe; E-mail I dërguar nga për dh të datës 18.05.2022 me korrespondim prej 1-3 faqe; E-mail I dërguar nga për të datës 27.07.2022 me korrespondim prej 1-3 faqe; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 19.01.2022 me korrespondim prej 1 faqe ; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 12.10.2022; E-mail i dërguar nga për dhe te uates 12.10.2021; E-mail i dërguar nga për dhe të datës 08.10.2021; E-mail I dërguar nga për dhe të datës 07.10.2022; E-mail i dërguar nga për të datës 07.10.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 05.10.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 05.10.2021; E-mail i dërguar nga për te datës 04.10.2021; E-mail I dërguar nga nga për të datës 30.09.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 30.09.2021; E-mail I dërguar nga për , dhe të datës 30.09.2021; E-mail I dërguar nga për , dhe të datës 23.07.2021; E-mail I dërguar nga për të datës 30.09.2021; E-mail i dërguar nga për , dhe të datës 30.09.2021; E-mail I dërguar nga për të datës 26.10.2021; E-mail i dërguar nga I për të datës 26.10.2021; E-mail I dërguar nga për të datës 26.10.2021; E-mail i dërguar nga për SH.N të datës 03.11.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 05.11.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 17.10.2021; E-mail i dërguar nga për , dhe të datës 30.11.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 22.12.2021; E-mail i dërguar nga për të datës 05.01.2022; E-mail I dërguar nga për të datës 21.01.2022; E-mail i dërguar nga për të datës 05.06.2022 me korrespondim prej faqes 15-59; E-mail i dërguar nga për dhe të datës 26.01.2022 me korrespondim prej faqes 105-110; E-mail i dërguar nga K.K për të datës 03.02.2022 me korrespondim prej faqes 119-122; E-mail i dërguar nga K.K për të datës

25.01.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] të datës 19.01.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] të datës 15.03.2022 me korrespondim prej 1-10 faqe; Kërkesë për lyerjen dhe ndërrimin e tepiahve në zyren 110 ,111,132,133 dhe 134 me numër protokolli 1179/2022 të datës 24.03.2022; Kërkesë për lyerjen e zyreve dhe korridoreve të MKRS-së të datës 16.08.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] të datës 16.02.2022 me korrespondim prej faqes 1-2; Vendimi i lëshuar nga Ministria e Kulturës , Rinisë dhe Sportit me numër 246/2022 të datës 22.03.2022; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër 695/2022 të datës 24.06.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] B.B të datës 19.11.2021 me korrespondim prej faqe 1-6; Vendim i lëshuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me numër 26/2022 të datës 28.01.2022; E-mail i dërguar nga [redacted] për [redacted] të datës 01.04.2022 me korrespondim prej faqe 1-8.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi Shkelzen Nuza, është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit në pozitë: *“Udhëheqës i Divizionit për Teknologjisë Informativë dhe Shërbimeve të Përgjithshme”*, sipas Vendimit me numër referencë 2758/2014 i datës 20.06.2014 (bazuar në Akt emerimin nr.2380/2012 i datës 19.10.2012), ndërsa ndaj të njëjtit me datë 04.08.2022 zv. Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, ka bërë parashtruar kërkesën me numër 3411/2022, duke kërkuar inicimin e procedurës disiplinore, me dyshimin se ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.

Po ashtu nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor përmes Vendimit me numër:08/2022 të datës 04.10.2022, i ka shqiptuar masën disiplinore ankuesit *“ndalim prej 30 % të pagës për periudhën prej katër (4)muaj”* me arsyetimin se i njëjti nuk përmbushur detyrat e tij të punës për të cilat është i emëruar duke shkelur kështu dispozitat e ligjit material, respektivisht ka shkelur nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1, 3.3 dhe 3.10 të Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, po ashtu nga shkresat e administruara të lëndës ka ardhur në përfundimin se ndërlidhur me kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të datës 04.10.2022, Komisioni Disiplinor është njoftuar më së largu deri me datë 05.10.2022 përmes e-mailit të dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore, respektivisht përmes të njëjtit e-mail Njësia e Burimeve Njerëzore e kishte njoftuar ankuesin për inicimin e procedurës disiplinore ndaj tij, duke e mbajtur në cc. (të njoftuar) anëtarin e Komisionit Disiplinor T. Balaj, po ashtu Kolegji i Këshillit ka gjetur se Kryesuesi i Komisionit Disiplinor me datë 02.09.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.07/2022 për vazhdimin e afatit të procedurë vendimmarrëse deri me datë 04.10.2022.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 12 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë *“Komisioni disiplinor duhet të marrë vendim brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për inicim të procedurës nga njësia për burime njerëzore”*, si dhe nenit 10 paragrafi 6 i së njëjtës rregullore ku parashihet se: *“Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative”* dhe ka ardhur në përfundimin se Kryesuesi i Komisionit Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.07/2022 përmes të cilit i

kishte shtyrë afatin fillestar të vendimmarrjes në procedurën disiplinore edhe për 30 ditë kalendarike, ka vepruar në kundërshtim me nenin 99 paragrafi 2 dh 3 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "2. Shtyrja sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative dhe duhet të jetë në përpjesëtim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar. 3. Vendimi procedural i shtyrjes së afatit fillestar dhe data e re e mbarimit të tij, i njoftohet palës, brenda afatit fillestar dhe duhet të jetë e arsyetuar", pasi që lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore Komisioni Disiplinor ishte njoftuar me datë 05.08.2022 ndërsa vendimi për shtyrjen e afatit fillestar është marrë me datë 02.09.2022 gjegjësisht në ditën njëzetë e nëntë (29), dhe se nga shkresat e administruara të lëndës institucioni punëdhënës nuk ka arritur ta dëshmojë me prova nëse njoftimi për marrjen e vendimit për shtyrjen e afatit i është njoftuar palës brenda afatit fillestar, po shtyrja e afatit të vendimmarrjes deri me datë 04.10.2022 është në kundërshtim me nenin 99 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që prej datës 05.08.2022 kur Komisioni Disiplinor ka pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore e deri në momentin e shqyrtimit të saj respektivisht deri në nxjerrjen e vendimit nuk ka mundur të jetë më i madh se gjashtëdhjetë (60) ditë, ndërsa Komisioni Disiplinor Vendimin me numër:08/2022 e ka nxjerr 04.10.2022 apo në ditën gjashtëdhjetë e një (61), nga rrjedh se vendimi i goditur përmes kësaj ankese sikurse edhe vendimi për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes lidhur me procedurën disiplinore janë bërë në kundërshtim me procedurat dispozitat e ligjit për procedurën e përgjithshme si dhe dispozitat e aplikuara ligjore që për bazë kanë ligjin material.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sikurse dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankuesit është e bazuar, ndërsa me Vendimi numër protokolli:08/2022 i datës 04.10.2022 përmes të cilit Komisionit Disiplinor ankuesit i kishte shqiptuar masë disiplinore, është vendim i paligjshëm siç përcaktohet edhe me nenin 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material", dhe si i tillë Vendimi numër protokolli:08/2022 i datës 04.10.2022 i Komisionit Disiplinor është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi lidhur me shkeljet e evidentuara procedurale.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nëse institucioni punëdhënës, respektivisht Ministria e Drejtësisë, nuk ka marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 130 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashitimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën" dhe nëse Vendimin e Komisionit Disiplinor e ka ekzekutuar duke ia ndal ankuesit 30% të pagës, të njëjtit obligohen që t'ia kompensojnë shumën e ndaluar në emër të Vendimit numër 08/2022 i datës 04.10.2022 Komisionit Disiplinor, pasi që Këshilli ka konstatuar se vendimi si i tillë është i kundërligjshëm dhe se i njëjti nuk mund të prodhojë efekte juridike ndaj palës.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.951/2022.

Zyle MILLAKU GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe ,
- Arkivit të KPMSHCK-së.